

URDHËR

Nr. 166, datë 24.5.2019

PËR PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONIN PËR PAJISJEN ME LICENCËN E "IMPORTIT TË SUBSTANCAVE OZONHOLLUESE" KODI III.3, SI DHE PËR PEZULLIMIN/ REVOKIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe të pikës 2, të kreut VII, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019, "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca",

URDHËROJ:

1. Miratimin e procedurave dhe dokumentacionin për pajisjen me licencë "Importi të substancave ozonholluese", kodi III.3, si dhe procedurave për pezullimin / revokimin e saj, sipas tekstit dhe shtojcës 1/a dhe 1/b bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen sektori i monitorimit të lejeve dhe licencave në fushën e mjedisit, drejtoria përgjegjëse për politikën e substancave ozonholluese në Ministri, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe inspektorati shtetëror përgjegjës për fushën e mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Blendi Klosi

I. Procedura dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti për pajisjen me licencën e importit të substancave ozonholluese

1. Çdo person fizik ose juridik që ushtron veprimtari importi të substancave të kontrolluara, për t'u pajisur me licencën e "Importit të substancave ozonholluese" me kodin III.3, aplikon pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), duke dorëzuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën drejtuar ministrisë përgjegjëse për mjedisin, për pajisje me licencë importi të substancave ozonholluese. Kërkesa duhet të përmbajë në mënyrë të saktë dhe të plotë të dhënat e specifikuar në akt miratimin për pajisje me licencë, të përcaktuar në shtojcën 1/a, të këtij urdhri;

b) diplomë e shkollës së mesme ose diplomë universitare për drejtuesin teknik;

c) kontratën e punës që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës me drejtuesin teknik;

d) vërtetim i pronësisë ose kontrata e marrjes me qira të mjediseve;

e) vetëdeklarim mbi përshtatshmërinë e mjediseve dhe pajisjeve.

2. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) përcjell në mënyrë elektronike pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), aplikimet e subjekteve për pajisje me licencë "Importi të substancave ozonholluese" kodi III.3. AKM-ja shkarkon aplikimet e subjekteve për pajisje me këtë licencë dhe i përcjell ato menjëherë pranë sektorit të monitorimit të lejeve dhe licencave në fushën e mjedisit, në Ministri.

3. Sektori i monitorimit të lejeve dhe licencave në fushën e mjedisit, pas marrjes së aplikimit për licencë nga AKM-ja, shqyrton aplikimin dhe dokumentacionin shoqërues dhe harton aktin e miratimit/refuzimit të licencës së "Importit të substancave ozonholluese" kodi III.3, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, të këtij urdhri.

4. Ministri, nënshkruan aktin e miratimit/ refuzimit për dhënien e licencës që publikohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, brenda 20 ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit.

5. Në rastin kur subjekti nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe/ose dokumentacioni ka mangësi, Ministri nënshkruan aktin e refuzimit.

II. Pezullimi dhe shkaqet dhe procedurat e pezullimit të licencës së importit të substancave ozonholluese

1. Licenca e "Importit të substancave ozonholluese", pezullohet kur:

a) mbajtësi i licencës nuk përmbush kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019 "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substance", si dhe legjislacionit në fuqi për substancat ozonholluese;

b) në rast se subjekti nuk përmbush detyrimin e raportimit brenda afatit ligjor, të përcaktuar në VKM nr. 10, datë 9.1.2019 "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substance".

2. Konstatimi i mospërmbushjes së kriterëve dhe mos moszbatimi i detyrimeve ligjore kryhet nga Inspektorati Shtetëror përgjegjës për mjedisin.

3. Drejtoria përgjegjëse për politikën e substancave ozonholluese në Ministri, i propozon ministrit pezullimin e licencës në rast se subjekti nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në pikën 1.b, të këtij kreu.

4. Ministri përgjegjës për mjedisin, nënshkruan aktin e pezullimit të licencës.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, publikon aktin e pezullimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

I II. Revokimi dhe shkaqet dhe procedurat e revokimit të licencës së importit të substancave ozonholluese

1. Licenca e "Importit të substancave ozon holluese", revokohet kur:

- a) mbajtësi i licencës nuk përmbush detyrat e lëna në aktin e pezullimit brenda afatit kohor të përcaktuar në këtë akt;
- b) mbajtësi i licencës ka shkelur, në mënyrë të përsëritur, dispozitat e legjislacionit në fuqi për lëndët ozonholluese;
- c) subjekti i licencuar ka tejkaluar kuotën e miratuar për import të lëndëve ozonholluese;
- d) kur vërtetohet se personat juridikë/fizikë kanë paraqitur deklarime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës për të cilën kanë aplikuar apo edhe gjatë raportimit;
- e) mbajtësi i licencës nuk përmbush kushtet e parashikuara në të;
- f) mbajtësi i licencës bën kërkesë për heqje dorë nga licenca.

2. Në vijim të marrjes së propozimit nga inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin, ose Drejtoria përgjegjëse për politikat e substancave ozonholluese në Ministri, Ministri përgjegjës për mjedisin, nënshkruan aktin e revokimit të licencës.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, publikon aktin e revokimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

IV. Dispozita kalimtare

1. Çdo palë e interesuar, subjekt i VKM-së nr. 10, datë 9.1.2019 "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca", ka të drejtën e ankimit në rrugë administrative, me kërkesë në QKB, ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të Ministrisë.

SHTOJCA 1/a

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT MINISTRI

Tiranë, më . .2019

AKT MIRATIMI

PËR PAJISJEN ME LICENCË IMPORTI TË SUBSTANCAVE OZONHOLLUESE

Në zbatim të pikave 4 dhe 5, të kreut I, të këtij urdhri dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019, "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca", dhe me propozim të strukturës përgjegjëse për licencimin e substancave ozonholluese, Ministri,

VENDOSI:

Miratimin për dhënien e licencës së importit të substancave ozonholluese me të dhënat, si më poshtë:

1. Nr. i miratimit:

2. Emri i personit fizik/juridik që importon:

Numri i Kodit të Regjistrimit të Importuesit (Kodi UNIK):

NIPT:

Adresa (qyteti, rruga nr. etj.):

Nr. i telefonit:

Fax ose e-mail:

Emri i drejtuesit teknik:

3. Përshkrimi i qëllimit të importit/përdorimit:

a) për mbrojtjen e jetës së njerëzve/bimëve/kafshëve etj.;

b) për mbrojtjen kundër zjarrit;

c) për sigurinë e transportit;

d) për qëllim të kërkimeve shkencore.

e) të tjera. Shënim: të përshkruhet qëllimi i importit të substancës ozonholluese, përdoruesi dhe arsyeja e përdorimit të këtyre substancave.

4. Përdoruesi i fundit i substancës ozonholluese:

5. Përdoruesi i fundit i produkteve që përmbajnë substanca ozonholluese:

6. Data e dhënies së licencës së importit dhe afati i përdorimit të licencës.

Licenca është e pavlefshme nëse nuk shoqërohet me akt miratimin që përcakton kuotat e importit për substancat ozonholluese për këtë subjekt.

7. Me pajisjen e kësaj licence, personi fizik/juridik ka detyrimin për të raportuar në mënyrë periodike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për substancat ozonholluese.

MINISTËR

Emër MBIEMËR

(firma, vula)

SHTOJCA 1/b

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT MINISTRI

Nr. prot. Tiranë, më . .2019

AKT REFUZIMI

PËR PAJISJEN ME LICENCE IMPORTI TË SUBSTANCAVE OZONHOLLUESE

Në zbatim të pikave 4 dhe 5, të kreut I, të këtij urdhri dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019, "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca", dhe me propozim të strukturës përgjegjëse për licencimin e substancave ozonholluese, Ministri,

VENDOSI:

Refuzimin për dhënien e licencës së importit të substancave ozonholluese me të dhënat si më poshtë:

1. Nr. i refuzimit:

2. Emri i personit fizik/juridik që importon:

Numri i Kodit të Regjistrimit të Importuesit (Kodi UNIK):

NIPT:

Adresa (qyteti, rruga nr. etj.):

Nr. i telefonit:

Fax ose e-mail:

Emri i drejtuesit teknik:

3. Arsytet e refuzimit:

1.

2.

MINISTËR

Emër MBIEMËR

(firma, vula)